01 Nr. 505/24 Dt. 20.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

- Formohet dhe emërohet Komisioni për pranimin teknik të punimeve në projektin: “Ndërrimi i dyerve të klasave me anësore metalike (22 klasa)” në SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Dalip Shabanaj,prof i biologjisë,
 - 1.2. Beniamin Ibrahim, farmacist,
 - 1.3. Blend Selmani,doktor.
- Detyrat e Komisionit do të jenë: të verifikoj punimet e realizuara nga ana e OE “ELK GROUP” shpk nga Gjakova dhe të bëj pranimin teknik të punimeve të realizuar në projektin: “Ndërrimi i dyerve të klasave me anësore metalike (22 klasa) në SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren me nr. të kontratës 622-24-2727-2-3-6/C1383, konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.





01 Nr. 507/24 Dt. 20.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejin e realizimit të projektit: “Rekonstruimi i rrugës Reçan-Lubinje e Epërme-Lubinje e Poshtme” kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nr. 10041.
3. Ky projekt realizohet konform Memorandumit të Mirëkuptimit, për financimin e projektit infrastrukturor në Komunën e Prizrenit, i nënshkruar mes Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - MMPHI,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 506/24 Dt. 20.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për pagesë të faturës së “PROMO GLOBAL” (Kompani për shërbime biznesi dhe marketingu) nga Zagrebi i Republikës së Kroacisë, për shërbimin: Shërbimet e Porositura në Projektin “Globallocal” 2023/2024, sipas porosis së blerjes –paketë shërbimi Gold, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 1.890,00 € (njëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Mjetet e lartcekura, si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të alokohen (bëhet pagesa) në xhirollogarinë nr. –IBAN: HR55 2340 0091 1110 3006 1, SWIFT: PBZGHR2X, Privredna banka Zagreb, d.d. Radnička cesta 50, 10 000 Zagreb, Hrvatska.
4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 509/24 Dt. 22.08.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e pjesëmarrjes së Komunës së Prizrenit-DTZHE në “Global Albanian Gastronomy Festival”, që organizohet në Berlin të Republikës së Gjermanisë nga data 02 tetor 2024 deri me 03 tetor 2024, si dhe mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në këtë panair dhe pagesa e mëditjeve. Kështu që, i lejohej Komunës së Prizrenit- DTZHE, pjesëmarrja në këtë organizim (garë) si dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të pjesëmarrjes: mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit, pagesa e akomodimit, qëndrimit, ushqimit në hotel të stafit pjesëmarrës në këtë panair, si dhe të shpenzimeve të paparashikuara, lejohen mjetet e nevojshme financiare.
 2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 30 shtator 2024 dhe kthimi me 04 tetor 2024.
 3. Në këtë organizim të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi, udhëtimi zyrtar i pjesëmarrësve është në këtë përbërje: Kujtim Gashi-nënkryetar i Komunës, Ramadan Tarashaj,-drejtor i DTZHE, Jona Hoxhaj –zyrtare për Marrëdhënie me Publikun, Granit Shoshaj-asistent administrativ dhe Sherife Çengaj-zyrtare për promovimin e Turizmit, dhe për të njëjtit lejohej pagesa e mëditjeve konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 dhe 2 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës– pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
 5. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurëve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





01 Nr. 514/24 Dt. 26.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e realizimit të projektit: “Ngritja e pemishtes me pemë të imta-dredhëz, mjedër”, me bashkëfinancim me fermerët,-vazhdim i projektit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor- pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



01 Nr. 511/24 Dt. 26.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit

1. Lejohet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Vendimit nr. 01 nr. 437/24, i datës 18.07.2024, që ka të bëjë me lejin e transportit të nxënësve udhëtar për vitin shkollor 2024/2025, kështu që, pikës 1 të këtij Vendimi i shtohet edhe 1 (një) nënpikë me nr. rendor 1.8. dhe do të jetë: Karashëngjergj-Zym.
2. Pjesët tjera të Vendimit nr. 01 nr. 437/24, i datës 18.07.2024, mbesin të pandryshuara.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 512/24 Dt. 26.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, konform procesverbalit të datë 21.05.2024 të Menaxherit të Kontratës, për lejimin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: “Ndërtimi i aneksit shkollor në fshatin Vërmicë”, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti, lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 33.861,95 € (tridhjetë e tremijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e pesë cent).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t’i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-23-1622-5-2-1/C1101 të datës 05.04.2023, me OE – “TOP PROJECT” SHPK.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, nr. 52153.
4. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye, Başkani

01 Nr. 513/24 Dt. 26.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, konform procesverbalit të datë 07.05.2024 të Menaxherit të Kontratës, për lejin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: “Ndërtimi i objektit shkollor “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” (ish Pjetër Mazreku) në fshatin Mazrek, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 63.547,20 € (gjashtëdhjetë e tremijë e pesëqind e katërdhjetë e shtatë euro e njëzet cent).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t'i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-23-552-5-1-1/C1088 të datës 27.04.2023, me OE – “TOP PROJECT” SHPK.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, nr. 40755.
4. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



01 Nr. 518/24 Dt. 27.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

- Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj njoftimit të publikuar nga ana e Komisionit që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave sipas shpalljes publike, për ndarjen e vijave të transportit publik të udhëtarëve të komunikacionit urban për vitin 2024-2025, me nr. reference 05-343/92115 datë 17.07.2024. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Përparim Shala,kryesues i komisionit,
 - 1.2. Zekë Tejci,anëtar,
 - 1.3. Agnesa Thaqi Kurejshi,anëtare.
- Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me shpalljen publike, për ndarjen e vijave të transportit publik të udhëtarëve të komunikacionit urban për vitin 2024-2025, me nr. reference 05-343/92115 datë 17.07.2024 dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
- Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe të emëruarit e këtij Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.





01 Nr. 524/24 Dt. 30.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M
Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet komisioni për asgjësimin e pasurisë (gjësendet) të rekomanduara nga ana e Komisionit të formuar me vendim 01 nr. 020/2024 datë 18.01.2024. Për anëtarë të këtij Komisioni, emërohen:
 - 1.1. Afrim Gashinga DA,
 - 1.2. Osman Osmanaj.....nga DA,
 - 1.3. Agron Ukimeri.....nga DA.
2. Detyrat e Komisionit të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, të bëjnë asgjësimin e pasurisë (gjësendeve) të cilat pasuri janë rekomanduar për asgjësim nga ana e Komisionit të formuar me vendim 01 nr. 020/2024 datë 18.01.2024.
3. Komisioni është organ i përkohshëm dhe mandati i tij përfundon me kryerjen e asgjësimit të pasurisë e përshkruar si në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
5. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës;
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





01 Nr. 526/24 Dt. 30.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë, konform kërkesës së OE "EBK" shpk dhe raportit të Organit Mbikëqyrës dhe Menaxherit të Kontratës, për lejin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: "Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në ambientet e ish KFOR-it në Prizren" projekt tre vjeçar, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti, lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 113.572.00 € (njëqind e trembëdhjetëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy euro).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t'i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-21-6326-5-1-1.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Shëndetësisë, nr. 51098.
4. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.





01 Nr. 525/24 Dt. 30.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e realizimit të një punëtorie për hartimin e raportit të të gjeturave gjatë procesit të implementimit të projektit “Vizitat shëndetësore sistematike” në shkollat fillore të mesme të ulëta të Komunës së Prizrenit, për nxënësit e klasave I, V, IX, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare dhe shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Punëtorja do të realizohet jashtë vendit ku do të merr pjesë stafi i cili ka realizuar vizitat sistematike dhe do të zgjatë (do të jetë) 3 ditë e dy 2 net.
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shëndetësisë-mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 523/24 Dt. 30.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e hartimit të projekteve detale si në vijim:
 - 1.1. Hartimi i projektit detal për ndërtimin e objektit të komunës,
 - 1.2. Hartimi i projektit detal për ndërtimin e parkingjeve të “Shtëpia e Bardhë”.
2. Për realizimin e projekteve të cekura si në pikën 1 të këtij Vendimi lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike-mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.





01 Nr. 521/24 Dt. 30.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, dhe lejohet fillimi i procedurave ligjore nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës, për parcializimin e pronës (copëtimi i parcelës) me nr. të ngastrës kadastrore 00001-104 ZK-Prizren sipas gjendjes faktike (skicës) në terren.
2. Parcializimi (copëtimi i parcelës) bëhet me qëllim të realizimit të projektit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.
3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastrë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 522/24 Dt. 30.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, konform kërkesës së OE GEO “Flori” shpk & “Joos & Krasniqi-Baze” shpk, dhe kërkesës (raportit) të Menaxherit të projektit, për lejin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: “Ndërtimi i kanalizimit të hapur, mureve mbrojtëse dhe rregullimi i rrugicave në Krushë të Vogël” projekt dy vjeçar, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti, lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 47.492,00 € (katërdhjetë e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy euro).
2. Paga e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t’i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-24-154-511.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, nr. 52728.
4. Me këtë vendim anulohet Vendimi 01 nr. 485/24 i datës 08.08.2024.
5. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit





01 Nr. 520/24 Dt. 30.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e parë (kësti I) për sigurimin e hapësirës për pjesëmarrjen e Komunës së Prizrenit-Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomikë në Panairin "Global Albanian Gastronomy Festival", që organizohet (mbahet) në Berlin të Republikës së Gjermanisë nga data 02 tetor 2024 deri me 03 tetor 2024, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 6.440.00 € (gjashtëmijë e katërqind e katërdhjetë euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

